



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 315, datë 11.5.2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE KRITEREVE QË DUHET
TË PLOTËSOJNË *STARTUP*-ET DHE LEHTËSUESIT
E *STARTUP*-EVE, SI DHE MIRATIMIN E PROCEDURAVE
DHE AFATEVE TË THIRRJES PËR PËRFITIMIN E GRANTEVE
DHE MASAVE MBËSHTETËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr.25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave për mbështetjen me grant të *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve, të cilët zhvillojnë projekte inovative në fusha prioritare për zhvillimin e vendit, si:
 - a) Mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
 - b) Mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
 - c) Fuqizimi i rinisë;
 - ç) Fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse;
 - d) Fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
 - dh) Prioritete të tjera, sipas urdhrit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

2. Nga kjo mbështetje me grant mund të përfitojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik, sipas nenit 11, të ligjit nr.25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.
3. Përfitimi i *startup*-eve ose lehtësuesve të *startup*-eve nga mbështetja e programeve apo projekteve nga donatorët apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për mbulimin e shpenzimeve të projektit, të cilat janë kontribut i vetë kërkuesit dhe nuk mbulohen nga ky grant, nuk përbën pengesë për përfitimin e grantit, për të njëjtin projekt.

II. KËRKESAT DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN E GRANTIT

1. Përfitojnë mbështetje me grant *startup*-t, sipas klasifikimit të mëposhtëm:
 - a) *Startup*-et në fazën fillestare;
 - b) *Startup*-et në fazën e rritjes;
 - c) *Startup*-et në fazën e zgjerimit.
2. Mbështeten me grant *startup*-et që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) *Startup*-et në fazën fillestare, që kanë përfunduar ose janë duke ndjekur një program inkubimi/përshpejtimi;
 - b) *Startup*-et në fazën e rritjes, që janë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 0-1 vit;
 - c) *Startup*-et në fazën e zgjerimit, që janë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 1-5 vite.
3. Aktivitetet e lejuara në projektet e *startup*-eve, që do të përfitojnë mbështetjen me grant ,përfshijnë, si më poshtë vijon:
 - a) Pjesëmarrje në aktivitete, konkurse, panairë ndërkombëtare;
 - b) Pjesëmarrje në programe ndërkombëtare inkubimi deri në 3 (tre) muaj;
 - c) Rritje aftësish/kapacitetesh teknike;
 - ç) Blerje makinerie dhe/ose pajisjeje pune;
 - d) Zhvillimi i tregtisë elektronike dhe/ose *software*;
 - dh) Patenta dhe licenca;
 - e) Lëndë e parë dhe ambalazhim/etiketim produkti.
4. Përfitojnë mbështetje me grant lehtësuesit e *startup*-eve, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- a) Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private;
 - b) Lehtësuesit, si inkubatorët dhe përshpejtuesit;
 - c) Hapësirat e punës, të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës;
 - ç) Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës;
 - d) Organizuesit e eventeve;
 - dh) Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private.
5. Mbështeten me grant lehtësuesit e *startup*-eve, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- a) Duhet të jenë persona fizikë ose juridikë të regjistruar, përfshirë dhe organizatat jofitimprurëse;
 - b) Kanë fushë kryesore të veprimtarisë së tyre trajnimin, këshillimin ose dhënien e mbështetjes, nëpërmjet formave të ndryshme në fushën e inovacionit dhe/ose të teknologjisë ose në fusha të ngjashme me to;
 - c) Duhet të kenë përvojë në ofrimin e shërbimeve për mbështetjen e *startup*-eve, të cilat mund të përfshijnë:
 - i. ofrimin e ambienteve dhe hapësirave të punës, duke mundësuar regjistrimin e selive ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive të biznesit në favor të *startup*-eve;
 - ii. ofrimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe shërbimeve të biznesit, të tilla si, zyra, ambiente dhe pajisje pune, kancelari, shërbime interneti me bandë ultra të gjerë, furnizim me energji dhe ujë;
 - iii. administrimin ose drejtimin nga persona me kompetenca dhe nërvojë në biznes dhe inovacion;
 - iv. marrëdhënie të rregullta me institucione të arsimit të lartë, qendra kërkimore-shkencore apo partnerë financiarë, që kryejnë aktivitete dhe projekte në lidhje me *startup*-et;
 - v. ofrimin e programeve të inkubimit dhe/ose përshpejtimit, duke ofruar mentorim dhe këshillim, për realizimin dhe zhvillimin e ideve të biznesit, trajnim nëpërmjet ekspertësh të kualifikuar.
6. Aktivitetet e lejuara në projektet e lehtësuesve të *startup*-eve, që do të përfitojnë mbështetjen me grant, përfshijnë, si më poshtë vijon:
- a) Infrastrukturë për krijimin e ambienteve dhe programeve të inkubatorëve;
 - b) Rritje kapacitetesh për stafin e universiteteve;
 - c) Hapësirë e përbashkët pune, e mbyllur me sistem rezervimi *on-line*;

- ç) Konkurse kombëtare për *startup*-et (të përshkallëzuar nga kombëtarë në ndërkombëtarë);
- d) Evente trajnimi/ndërgjegjësimi për *startup*-et me shtrirje kombëtare, në bashkëpunim me të paktën një partner ndërkombëtar;
- dh) Shërbime mbështetëse, ekspertizë, shkëmbim njohurish për *startup*-et nga ekspertë ndërkombëtarë;
- e) Evente ndërkombëtare në hapësirën e përbashkët të punës, me një audiencë me më shumë se 100 (njëqind) persona;
- f) Akademi inovacioni për të rinjtë dhe bizneset (njohjen me teknikat e projektimit, gjenerimit të idesë, teknologjitë e reja dhe aplikimin e tyre në biznes).

III. PROCEDURAT DHE AFATET PËR PËRFITIMIN E GRANTIT

1. Kërkesa për mbështetje me grant do të kryhet *on-line*, nëpërmjet faqes dhe adresës elektronike të ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen.
2. Kërkesat i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga ana e komisionit të vlerësimit, siç parashikohet në pikën 4, të nenit 14, të ligjit nr.25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.
3. Miratimi i dhënies së grantit merret me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga ana e ministrit përgjegjës për sipërmarrjen të vendimit të komisionit të vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 14, të ligjit nr.25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.
4. Projektet e shpallura fituese duhet të zbatohen në një afat maksimal 5 (pesë)-mujor nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së fitimit të grantit, midis përfituesit dhe ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.
5. Disbursimi i grantit për projektet e shpallura fituese bëhet deri në 3 këste, pas përfundimit të periudhës së mbylljes së çdo faze të projektit, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në “Rregulloren e funksionimit grantit”.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Në ushtrimin e detyrave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, ministri përgjegjës për sipërmarrjen mbështetet nga sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

~~KRYEMINISTRI~~

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

EDONA BILALI



NR.PROT. 2327/1
DATË 12.5. 2022

MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E
SIPËRMARRJES
KËSHILLIT EKONOMIK KOMBËTAR ✓
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

